

MUHARREM DEZHGIU

**MBLEDHJA E MUKJES NË KONTEKSTIN E ÇËSHTJES
KOMBËTARE SHQIPTARE***

Mbledhja e Mukjes, e fillimgushtit 1943, përbën një nga ngjarjet më kulmore politike të historisë shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Misioni historik i saj ishte të përcaktonte parimet, rrugët dhe formën e bashkimit të organizuar të forcave politike shqiptare dhe për rrjedhojë të mbarë shqiptarëve, për bashkim e çlirim kombëtar.

Analiza dhe shqyrtimi i vendimeve të Mbledhjes së Mukjes tregon qartë se ato i shërbenin në mënyrën më të drejtpërdrejtë bashkimit të shqiptarëve, në thelb të interesave kombëtare të shqiptarëve në të gjitha trojet e tyre etnike. Nga çdo anë që të analizohen vendimet e Mbledhjes së Mukjes, nuk mund të arrihet në përfundimin absurd, që ka predikuar historiografia komuniste se, ato vendime ishin në dëm të interesave të zhvillimit të luftës për çlirimin e Shqipërisë.

Nuk mund të gjykohen dhe të vlerësohen vendimet e Mbledhjes së Mukjes nga interesat e ngushta të njëjës apo tjetrës forcë politike. Analiza dhe vlerësimi i asaj marrëveshjeje mund të jetë i drejtë dhe objektiv, vetëm duke u nisur nga interesat kombëtare d.m.th. nga efekti që do të kishte ajo për çlirimin kombëtar. Gjykuar nga imperativi historik që shtrohej përpara shqiptarëve për gjetjen e formës dhe të organizimit më të përshtatshëm për mobilizimin dhe organizimin e gjithë shqiptarëve për çlirim kombëtar, themi se, vendimet e Mbledhjes së Mukjes e përmbushnin këtë mision.

Në kushtet historike të gjendjes politike e ushtarake të zhvillimeve në Shqipëri në verë 1943, kur forcat politike ekzistuese ishin pozicionuar qartë për luftë kundër pushtuesit, ishte domosdoshmëri historike për të gjetur një formë adekuate organizimi e koordinimi të bashkëpunimit të forcave politike. Këtë e bëri Mbledhja e Mukjes me marrëveshjen e arritur për forcimin dhe drejtimin e organizuar të luftës.

Komiteti i Shpëtimit të Shqipërisë (KSHSH), i zgjedhur nga Mbledhja e Mukjes, ishte organi më i lartë politik që do të bashkërendonte veprimtarinë e forcave politike pjesëmarrëse në luftë, në mënyrë që lufta të bëhej me efektin më të mirë kundër armikut të përbashkët. Me fjalë të tjera, KSHSH nuk synonte

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore mbi nacionalizmin në trojet shqiptare, organizuar nga shoqata “Vatra e Arbrit”, Shkup, 26 korrik 2009.

në asgjësimin e individualitetit organizativ të forcave politike, që kishin nënshkruar marrëveshjen, por ai do të bashkërendonte veprimtarinë e tyre luftarake, për të zgjidhur detyra të përbashkëta. KSHSH do të ishte organ i bashkimit të popullit shqiptar në luftë, sipas platformës të pranuar përgjithësisht “pa dallim feje, krahine apo bindjeje politike”. KSHSH shënonte një përsosje të formës së organizimit, duke iu përgjigjur nevojës së shkallës më të lartë të bashkëpunimit të forcave politike, të cilat do të ruanin njëherësh individualitetin e tyre të organizimit.

Si i tillë, KSHSH ishte organ drejtues i luftës dhe jo organ pushteti. Ai do të vepronte si i tillë deri në përfundim të luftës, pasi të bëheshin zgjedhjet e përgjithshme e të zgjidhej qeverisja e vendit, siç kishte vendosur edhe Mbledhja e Mukjes. Duke mos i dhënë KSHSH asnjë atribut si organ pushteti, Marrëveshja e Mukjes shmangu me shumë zgjuarsi, padurimin e forcave politike për pushtet, kur lufta vazhdonte akoma.

Vendimet e Mbledhjes së Mukjes me pjesëmarrjen e përfaqësuesve, nacionalistë e komunistë, të kurorëzuar me marrëveshjen përkatëse, përbënin një shembull të shkëlqyer të faktit se si interesat e grupimeve politike iu nënshtruan dhe u vunë në shërbim të interesave mbarëkombëtare.

Rrjedhjat e pritshme të realizimit të Marrëveshjes së Mukjes do të ishin me vlera të pallogaritshme kombëtare.

1. Procesi historik i bashkimit kombëtar të shqiptarëve në rrjedhën e luftës, do të forconte në maksimumin e mundshëm, pozitën politike të kombit shqiptar në fund të luftës në hapësirën ballkanike dhe evropiane.

2. Lëvizja Kombëtare Shqiptare do të fuqizohej më tej dhe do të hidhte bazat për një politikë kombëtare, ku politika të dominohej nga morali kombëtar.

3. Zbatimi i Marrëveshjes së Mukjes do t'i hapte rrugën zhvillimit të vendit në alternativën demokratike, duke krijuar një premisë të fuqishme për vendosjen e një regjimi demokratik në Shqipëri.

4. Arritja e Marrëveshjes së Mukjes shprehte shkallën më të lartë të emancipimit të potencialeve intelektuale e atdhetare të politikanëve shqiptarë që e finalizuan atë.

Suksesi i Mbledhjes së Mukjes në kontekstin e çështjes kombëtare shqiptare, rezonon dukshëm me frymën e shqyrtimit të çështjes së Kosovës, pjesë e pandarë e detyrës për zgjidhjen e çështjes kombëtare.

Njëmendësia për ta përfshirë çështjen e Kosovës në axhendën e Mbledhjes së Mukjes, që u arrit në mbledhjen e Tapizës, në fundkorrikun e vitit 1943, ishte një moment i rëndësishëm me peshë të madhe për arritjen e marrëveshjes.

Argumentet dhe kundërgargumentet e të dy forcave që merrnin pjesë në Mbledhjen e Mukjes, të Nacionalçlirimtares dhe të Ballit Kombëtar, për qëndrimin ndaj çështjes së Kosovës, ishin lehtësisht të dallueshme.

Koncepti i delegatëve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar ngulmonte në mendimin se nuk kemi punë me Kosovën, përderisa atë e kishin bashkuar fashistët me Shqipërinë dhe s'kemi si ta kërkojmë Kosovën përderisa atë e kishin kërkuar dhe profashistët. Duke ndjekur këtë vijë politike, PKSH dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, nuk e njohën bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duke e konsideruar madje, si një veprim demagogjik të pushtuesit . Në këtë mënyrë ata zhvlerësuan të gjitha avantazhet që pati ky bashkim për interesat kombëtare të shqiptarëve, në atë luftë çlirimtare.

Balli Kombëtar, bazuar në idenë e mbrojtur nga Mit'hat Frashëri, i përmbahej pikëpamjes se, pavarësisht kush e kishte bashkuar Kosovën me Shqipërinë, ky bashkim duhej njohur e pranuar si një fakt dhe duhej shfrytëzuar për të lidhur fijet e shkëputura me gjysmën tjetër të Shqipërisë, për të ngritur institucionet shqiptare, të cilat do të përfaqësonin institucionalisht popullsinë e këtyre trevave pas luftës.

Në mbështetje të kësaj pikëpamjeje, Mit'hat Frashëri vlerësoi saktë e bindshëm rrjedhojat tepër evidente të këtij bashkimi, pavarësisht nga rrethanat në të cilat u krye bashkimi apo koha e shkurtër e këtij bashkimi. Analiza e çështjes së Kosovës bëhej në kuadrin e situatës që po kalonte pushtuesi fashist, si një pushtues i përkohshëm. Nga ana tjetër analiza i referohej edhe pushtuesit serb, si pushtues i përhershëm, që ishte përpjekur t'i shkombëtarizonte, t'i asimilonte dhe t'i spastronte shqiptarët nga trojet e veta etnike.

Pjesa më fanatike komuniste e konsideronte problemin e Kosovës një çështje tabù, që i takonte vetëm Jugosllavisë. Madje, komunistët e konsideronin qëndrim shovinist, pikëpamjen e mbrojtjes së Kosovës si çështje kombëtare. Sipas tyre, "Të shtrosh çështjen e Kosovës e të kërkojsh të drejtën e saj për shkëputje e bashkim me Shqipërinë, do të thotë të biesh në gabimin shovinist të "Shqipërisë së Madhe". Madje, ata shkonin dhe më tej. Ngritja e kësaj çështjeje gjatë luftës ishte diversion për të larguar popullin nga lufta dhe ishte qëndrim kundër aleancave me fqinjët (!)

Këtyre pikëpamjeve iu kundërvijeh kryetari i Ballit Kombëtar me një mendim të qartë e të prerë. "Nuk jemi as për "Shqipërinë e Madhe" dhe as për "Shqipërinë e Vogël", jemi për Shqipërinë etnike, në të cilën banojnë tërësisht shqiptarë apo shumicë shqiptare e që kanë shprehur vullnetin të bashkohen si komb i vetëm, i ndarë padrejtësisht".

Sa për fqinjët, kryetari i Ballit Kombëtar i referohej historisë se, "ishin fqinjët që kishin hartuar platforma për "Serbinë e Madhe" dhe për "Greqinë e Madhe", të cilat kanë synuar e synojnë të gllabërojnë tokat e fqinjëve, siç aneksuan Kosovën e Çamërinë. Nga ana tjetër, kombi ynë nuk ka asnjë platformë të tillë ndaj kombeve të tjerë.

Argumentet që sillte Mit'hat Frashëri ishin bindëse dhe logjike, argumente që u pranuan dhe nga delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar.

Diskutimi i Mit'hat Frashërit kishte në thelb këto argumente:

1. Nuk është megalomani në qoftë se kërkojmë bashkimin kombëtar
2. Edhe në Kartën e Atlantikut flitet për vetëvendosjen e popujve
3. A duhet të heqim dorë nga Kosova vetëm pse tradhtarët flasin për të?

– shtronte pyetjen Mit'hat Frashëri.

Mbi bazën e këtyre argumenteve dhe të përgjegjësisë për çështjen kombëtare, Mbledhja e Mukjes e trupëzoi vendimin e vet për çështjen e Kosovës, me këtë formulë: *“Luftë për një Shqipëri independente dhe për zbatimin e parimit të njohur universalisht e të garantuar nga Karta e Atlantikut të vetëvendosjes së popujve, për një Shqipëri etnike”*.

Edhe pse Mbledhja e Mukjes e përcaktoi qartë qëndrimin e forcave politike ndaj çështjes së Kosovës, me bindjen se i shërbehej zgjidhjes së çështjes kombëtare në kushtet e një lufte botërore, vendimi mbeti pa u realizuar. Rolin kryesor në prishjen e Marrëveshjes së Mukjes e luajti politika tradicionale përçarëse, antishqiptare e fqinjëve që, në rastin e dhënë, u realizua nëpërmjet Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes udhëheqja e PKSH kaloi gjithnjë e më tepër në pozita antikombëtare. Ajo hoqi dorë pothuajse tërësisht nga politika e bashkimit kombëtar. Pasojë direkte e kësaj politike ishte copëtimi i mëtejshëm i trojeve shqiptare në Jugosllavi, lehtësimi i kryerjes së etnocidit serb në Kosovë dhe spastrimi i përgjakshëm etnik i Çamërisë. Kosova dhe Çamëria martire i paguan një haraç të rëndë ndarjes dhe konfrontimit të forcave politike në Shqipëri.

Mbledhja e Mukjes edhe pas afro 7 dekadash u përcjell shqiptarëve mesazhin për njohjen e të vërtetës historike mbi çështjen kombëtare shqiptare, për pasojat që pati për shqiptarët, prishja e njëanshme dhe tendencioze e kësaj marrëveshjeje. Dhe mbi të gjitha, të reflektojnë mbi gabimet, duke menduar e vepruar gjithmonë si shqiptarë për interesat e kombit tonë.